

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5; me nr. te prokurimit: 201/26300-25-11214-1-1-1;

1. Njoftimi për kontratë i datës 18.12.2025;
2. Dosja e tenderit e datës 18.12.2025;
3. Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 27.02.2026;
4. Kërkesa për rishqyrtim: 04.03.2026
5. Vendimi i kërkesës për rishqyrtim: 09.03.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

PO

Me datë 04.03.2026, kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Agjencioni Qendror i Prokurimit. Me datë 09.03.2026, është shpallur vendimi i këtij Autoriteti për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke e konsideruar atë të pabazuar.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 – Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 – Barazia në trajtim/ jo-diskriminimi

Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 59 – Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Neni 60 – Kriteret e dhënies

Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Te pa kënaqur me njoftimin B58 të datës 27.02.2026 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues:

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 dhe Lot 5** ; me nr. te prokurimit: **201/26300-25-11214-1-1-1** ; në afatin ligjor konform neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve dhe duke besuar që lëshimet gjatë vlerësimit ishin jo të qëllimshme dhe të ndodhur nga moskujdesi i duhur gjatë vlerësimit të ofertave, ushtrojmë këtë:

Kërkesë për rishqyrtim

Ne pajtohemi me eliminimin e dy ofertuesve, pasi që konsiderohet se nuk pranohen kredi të kushtëzuara dhe, në çdo formë që ato kushtëzohen, nuk përmbushin kriteret e dosjes së tenderit. Ndërsa për ofertuesin e rekomanduar për kontratë “Beni Dona”, kemi dyshime të bazuara se nuk e ka përmbushur gjithashtu kërkesën –

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar, respektivisht Kërkesa 2:

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare – qasje të pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës, ose bilanc pozitiv tek Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit në Pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025, në vlerë prej së paku:

Lot 1 – 100,000.00 €;

Lot 2 – 200,000.00 €.

Kjo pasi që vetë fakti që konsiderohet si sekret afarist ngre dyshime se kjo kërkesë nuk është përmbushur, duke u bazuar në dy pika:

1. Nëse ky OE ka mjete të gatshme në bankë, atëherë vetë fakti që është rekomanduar të shpërblehet me kontratë për dy lote lë të kuptohet se ka mbi 300,000 euro mjete të gatshme në bankë, andaj edhe nuk mund të cilësohet si sekret, pasi që është fakt që kuptohet shumë lehtë.
2. Nëse ka një kredi, nuk do të duhej të emërohej dokumenti “Dëshmi nga banka për mjete të gatshme”, siç është cekur, i cili dokument nuk mund të na ofrohet kur na është dërguar versioni i pastruar pas kërkesës sonë për qasje në dokumente.

Andaj, ne konsiderojmë se AK ka bërë shkelje të nenit 59 gjatë vlerësimit të ofertave, si dhe shkelje të nenit 11, duke mos na ofruar qasje në këtë dokument, edhe pse i njëjti nuk ndikon fare në fushën e afarizimit të asnjërës kompani.

Andaj, kërkojmë që të paktën në shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim të na bashkëngjiten edhe pjesë të atij dokumenti (ku vlerat apo ndonjë e dhënë tjetër që konsiderohet e ndjeshme të fshihen), por të paktën ta shohim si dokument se a janë mjete të gatshme apo kredi, ku do të kërkonim vetëm të shihet nëse është “kredi e pakushtëzuar”.

Bazuar në faktet që ofruam konsiderojmë që ka:

Shkeljet e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,

Shkeljet e LPP-së nga ana e AK-së

Shkelja e Nenit 1 – Qëllimi

Ligji për Prokurimin Publik ka për qëllim sigurimin e shfrytëzimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike.

Autoriteti Kontraktues, duke rekomanduar për kontratë një operator ekonomik për të cilin ekzistojnë dyshime të bazuara se nuk ka përmbushur kërkesën për kapacitet ekonomik dhe financiar dhe duke mos ofruar qasje në dokumentacionin përkatës me arsyetimin e “sekretit afarist”, ka vepruar në kundërshtim me qëllimin e këtij ligji, duke cenuar parimin e transparencës dhe shfrytëzimit të drejtë të fondeve publike.

Shkelja e Nenit 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

AK ka dështuar të sigurojë përdorimin ekonomik dhe efikas të fondeve publike, pasi ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik pa u vërtetuar përmbushja reale e kërkesës për kapacitet financiar, duke rrezikuar realizimin e kontratës dhe menaxhimin e përgjegjshëm të fondeve publike.

Shkelja e Nenit 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi

Autoriteti kontraktues nuk i ka trajtuar operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe transparente, pasi që për operatorin e rekomanduar për kontratë është pranuar dokumentacion që është shpallur si sekret afarist dhe nuk është ofruar për shqyrtim, ndërkohë që për ofertuesit e tjerë kërkesat janë zbatuar në mënyrë rigoroze.

Një veprim i tillë përbën shkelje të parimit të barazisë në trajtim dhe transparencës.

Shkelja e Nenit 52 – Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë për kapacitetin ekonomik dhe financiar nuk janë respektuar gjatë vlerësimit të ofertave, pasi që operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar në mënyrë të verifikueshme përmbushjen e këtyre kriterëve, megjithatë është shpallur si fitues.

Shkelja e Nenit 59 – Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Në kundërshtim me këtë nen, AK ka konsideruar si të përgjegjshme një ofertë që nuk është në përputhshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht me kërkesën **III.2.3 – Kapaciteti ekonomik dhe financiar**, pasi nuk është dëshmuar ekzistenca e mjeteve të gatshme në bankë apo qasja e pakushtëzuar në kredi.

Për më tepër, AK nuk ka siguruar transparencë gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertës, duke mos ofruar qasje në dokumentacionin përkatës.

Shkelja e Nenit 60 – Kriteret e dhënies

Duke qenë se kriteri i dhënies së kontratës ka qenë “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”, ky nen nuk është respektuar, pasi që kontrata i është rekomanduar një operatori ekonomik i cili nuk ka paraqitur ofertë të përgjegjshme për shkak të mospërmbushjes së kërkesës për kapacitet ekonomik dhe financiar.

Shkelja e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik – Neni 40

Neni 40 i kësaj Rregulloreje parasheh që gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, autoriteti kontraktues duhet të verifikojë përputhshmërinë e ofertave me kërkesat e

dosjes së tenderit.

Në këtë rast, AK nuk ka bërë një verifikim të plotë dhe të dokumentuar për përmbushjen e kërkesës për kapacitet financiar nga ana e operatorit të rekomanduar për kontratë, duke vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë.

Bazuar në provat dhe faktet e prezantuara kërkojmë që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe gjatë procesit të rivlerësimit të sqarohen të gjitha pretendimet e ngritura nga ne.

Shkelja e parimit të proporcionalitetit

AK ka aplikuar standarde të ndryshme vlerësimi për ofertues të ndryshëm, duke qenë më rigoroz ndaj disa operatorëve ekonomikë dhe më tolerant ndaj operatorit të rekomanduar për kontratë, gjë që përbën shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

Dyshim në ligjshmërinë e klasifikimit si “sekret afarist”

Klasifikimi i dëshmisë për kapacitetin financiar si “sekret afarist” është bërë në mënyrë të pabazuar, pasi që natyra e këtij dokumenti ka të bëjë vetëm me përmbushjen e një kriteri ligjor dhe jo me ndonjë teknologji, formulë apo strategji tregtare të operatorit ekonomik. Si i tillë, ky dokument nuk mund të përjashtohet nga qasja e palëve të interesuara.

Demantim i Njoftimit të AK-së lidhur me klasifikimin si sekret afarist

Pretendimi i AK-së se dokumenti “Dëshmia nga Banka për mjete të gatshme” është klasifikuar ligjërisht si sekret afarist në bazë të Nenit 11 të LPP-së nuk qëndron, për këto arsye:

1. **Dokumenti për kapacitet financiar nuk përbën sekret afarist në kuptimin material të ligjit**, pasi nuk përmban informata mbi teknologji, procese prodhimi, strategji tregtare apo elemente konkurrence, por vetëm dëshmon përmbushjen e një kriteri ligjor të dosjes së tenderit (kapacitet ekonomik dhe financiar).
2. **Vetë natyra e këtij dokumenti është verifikuese dhe jo konkurruese**, sepse shërben vetëm për të vërtetuar nëse operatori ekonomik i plotëson apo jo kërkesat minimale financiare të përcaktuara në dosjen e tenderit. Si i tillë, ai nuk mund të trajtohet si sekret afarist në raport me palët e interesuara në procedurë.
3. **Klasifikimi si sekret afarist është bërë në mënyrë të përgjithshme dhe pa arsyetim konkret**, pasi AK nuk ka sqaruar se cilat elemente specifike të këtij dokumenti përbëjnë sekret afarist dhe pse publikimi i tyre do të cenonte interesat legjitime të operatorit ekonomik.
4. **Neni 11 i LPP-së nuk lejon që përmes klasifikimit si sekret afarist të pengohet verifikimi i ligjshmërisë së vendimit të AK-së**, veçanërisht kur dokumenti në fjalë shërben për të dëshmuar përmbushjen e një kriteri thelbësor të përgjegjshmërisë së ofertës.
5. Edhe në rast se disa të dhëna numerike do të konsideroheshin të ndjeshme, **AK ka qenë e obliguar të ofrojë version të pastruar funksional**, nga i cili do të mund të konstatohej qartë nëse bëhet fjalë për:
 - o mjete të gatshme në bankë, apo
 - o kredi, dhe nëse kjo kredi është **e pakushtëzuar**, siç kërkohet në dosjen e tenderit.
6. **Versioni i pastruar i ofruar nuk mundëson një verifikim të tillë dhe, si i tillë, nuk e përmbush qëllimin e Nenit 11**, por përkundrazi shërben për të fshehur faktin nëse kërkesa për kapacitet financiar është përmbushur apo jo.

Andaj kërkohet që AK- AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT të marr:

V E N D I M

- Te aprovohet si e bazuar, ne tërësi ankesa e OE - Dauti Komerc SH.P.K.;
- Te kthehet lënda ne Rivlerësim dhe te vlerësohet të gjitha pretendimet e ngritura nga Ne.

8. Dëmet materiale

Humbja e një kontrate që bazuar në ligjin dhe rregulloren aktuale që janë në fuqi Ne kemi qenë ofertuesi që është dashur të shpërblehemi me kontratë. SI dhe për arsye te mos respektimit të LPP-së janë shfaqur edhe shpenzimet për shërbime te avokatisë por edhe shpenzimet e sigurimit të ofertës dhe fitimi i humbur.

